



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsu, 60000, Gjiilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net

tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E drejta penale-Pjesa e përgjithshme

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës: E drejta penale-Pjesa e përgjithshme	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	<i>E drejta penale-Pjesa e përgjithshme</i>
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve/Semestri:	Viti i II-të, Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror, Gjiilan
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Fejzullah Hasani
Asistent	Asistent: Dr. sc. Fatmire Krasniqi
Detajet kontaktuese:	fhasani60@hotmail.com, tel: 045-321-690
Përshkrimi i lëndës:	
	<i>E drejta penale-Pjesa e përgjithshme, përfshinë të gjitha nocionet, institutet dhe parimet e të drejtës penale.</i>
Qëllimet e lëndës:	
	Fitimi i njohurive për të drejtën penale në përgjithësi, për shkencën e të drejtës penale, për raportet e të drejtës penale me degët tjera të drejtësisë, karakteristikat e të drejtës penale gjatë zhvillimit të saj historik, nga një e drejtë zakonore jo racionale dhe jo humane në një të drejtë ligjore dhe racionale, karakteristikat e të drejtës penale të Kosovës për gjatë zhvillimit historik, fitimi i njohurive për parimet e të drejtës penale, nocionet dhe institucionet e të drejtës penale, veprimi i ligjit penal në kohë dhe hapësirë, shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë për veprën penale në përgjithësi, për format fajit, sanksionet penale, rehabilitimin në të drejtën penale etj.. Në përfundim të lëndës, studentët duhet të jenë të aftë të:

	kuptojnë dhe njohin të drejtën penale në aspektet teorike e veçmas në atë praktike; aplikojnë njohuritë e tyre në punët në sistemin e drejtësisë si dhe të përcjellin të arriturat shkencore në fushën e shkencës së të drejtës penale.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Duke qenë se qëllim parësor i kësaj lënde është ngritja e aftësive teorike dhe praktike e studentëve, përveç anës teorike që do të mësohet në ligjërata, studentët do të kenë rastin të njohin aspektin praktik të zbatimit të instituteve të së drejtës penale. Studentët për ushtrime do informohen paraprakisht lidhur me temat që do diskutohen dhe çdoherë do të ketë ligjërata interaktive dhe punë në grupe. Në fund të semestrit studenti do të jetë në gjendje që të kuptojë të gjitha nocionet dhe instutcionet e të drejtës penale, të njihet në mënyrë të thelluar për risitë qe sjell Kodi Penal dhe pa vështirësi do jenë në gjendje që këto parime, nocione dhe institucione t’i aplikojë në praktikë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	/	/	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0,5-1	30	30
Ushtrime në teren	/		/
Kollokfiume ,seminatre	2	2	4
Detyra të shtëpisë	/	/	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1.5	30	45
Përgatitja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim(teste,provim final	2	6	12
Projektet, prezantimet etj			
Totali			176
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata të përcaktuara sipas planprogramit, punë seminarike, prezantimet nga vet studentët, komunikimet inetraktive gjatë		

	zbatimeve të ushtrimeve. Ligjërata interaktive: Bashkëbisedim - duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me çështjet e ndryshme tematike. Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të përcaktohen për studimin e ndonjë temë apo punimi seminarik. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohen udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohet mundësia e prezantimit të punimeve të tyre para studenteve të tjerë. Pas prezantimit të këtyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund bëhet vlerësimi i punimit. Puna grupore: Debat shkencor. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose më shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore. Metodat e ligjërimit: Zakonisht do të aplikohen metoda bashkëkohore të ligjërimit, të cilat praktikohen në universitetet e ndryshme evropiane, prezantimi i temës përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temën e ligjërimit.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 30 pikë Testi i dytë: 50 pikë Provimi përfundimtar: 0-50% pikë Punim seminarik 0-10% Prezantime 0-5% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 0-5% pikë Totali: 100 pikë. Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.

Literatura	
Literatura bazë:	Prof. dr. Ismet Salihu, <i>E drejta penale-Pjesa e përgjithshme</i>, UP, 2016; <i>Komentari i Kodit Penal të Kosovës-Pjesa e përgjithshme</i>, grup autorësh, botimi 2013; <i>Kodi Penal i Kosovës (2018) si dhe Kodi Penal Drejtësia Për të Mitur</i>, 2018.
Literatura shtesë:	• Jean Pradel, Geert Corstens dhe Gert Vermeulen, <i>E drejta penale Evropiane/ Përkthim</i>, Paris, 2009. • Elezi, S. Kacupi dhe M. Haxhia, <i>Komenti i Kodit Penal të R. së Shqipërisë</i>, Tiranë, 1999. • Vlado Kambovski: <i>E drejta penale – Pjesa e përgjithshme</i>, Shkup, 2006. • George P. Fletcher: <i>Basic Concepts of Criminal Law</i>, Oxford, 1998. • Tulkens, Francoise&Von de Kerchove: <i>Introduction au droit penal</i>, Bruksel, 1999. • Fabrizio Ramacci: <i>Corso di diritto penale</i>, Torino, 2008. • Francesco Antolisei: <i>Diritto penale (Parte generale)</i>, Milano, 2008. • Giovanni Fiandaca, Enzo Musco: <i>Diritto penale (Parte generale)</i>, Bologna, 2010. • Dressler Joshua: <i>Understanding criminal law</i>, Second edition, New York, 1995. • Jean Pradel, Geert Corstens dhe Gert Vermuelen, <i>Droit penal europeen</i>, Dalloz, 2009. • Jean Pradel: <i>Droit Penal General</i>, Paris, 2000. • William A. Schabas: <i>International Criminal Court</i>, Cambridge, 2001. • Edit by Roy Gutman&DadivRieff: <i>Crimes of War</i>, New York, 1999. • <i>International Review of Penal Law/ Revue Internationale de Droit Penal</i>. • <i>Revista Illyrius (Revista e AIDP-Albanian Penalists Group)</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë:	- E drejta penale dhe shkenca e së drejtës penale - Marrëdhëniet e së drejtës penale ndaj degëve tjera të drejtësisë dhe ndarja e saj
Java e dytë:	- Shkenca e së drejtës penale dhe shkencat tjera penale - Kodi penal dhe legjislacioni penal - Burimet e së drejtës penale - Interpretimi i ligjeve penale

Java e tretë:	- Veprimi i legjislacionit penal
Java e katërt:	- Nocioni dhe elementet e veprës penale - Objekti dhe subjekti i veprës penale - Ndarja e veprave penale
Java e pestë:	- Veprimi, kundërligjshmëria - Shkaqet të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë - Përgjegjësia penale
Java e gjashtë:	Ora e parë: - Veprimet përgatitore dhe tentativa e veprës penale - Bashkimi i veprave penale Ora e dytë: - Debat me student lidhur me testin e parë semestral
Java e shtatë:	Testi i parë semestral
Java e tetë:	- Bashkëpunimi
Java e nëntë:	- Sanksionet penale - Dënimet - Dënimet kryesore - Dënimet alternative - Dënimet plotësuese
Java e dhjetë:	- Matja e dënimit
	- Vërejtja e gjykatës - Masat e trajtimit të detyrueshëm
Java e njëmbëdhjetë:	- Karakteristikat kryesore të ekzekutimit të sanksioneve penale
Java e dymbëdhjetë:	- Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale
Java e trembëdhjetë:	- Rehabilitimi, shlyerja e dënimit dhe kushtet për dhënien e të dhënave nga evidenca e të ndëshkuarve
Java e katërmbëdhjetë:	- Debat me student për testin e dytë dhe për provimin final
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë semestral
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	